



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr. 1035/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përbarimore të kreditorit “FE Doors” Sh.P.K., me numër unik identifikues 811409491 dhe seli në Prizren, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson sipas autorizimit V.O., avokat me seli në Prizren, kundër debitorit “German Doors” Sh.P.K., me numër unik identifikues 811253799 dhe seli në Fushë Kosovë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson sipas autorizimit F.S., avokat me seli në Prishtinë, duke vendosur sipas prapësimit të debitorit të ushtruar ndaj Urdhrit Përbarimor P.nr. 257/23, i lejuar më datë 15.06.2023, nga Përbaruesi Privat Liridon Tërshani me seli në Prizren, jashtë seancës, me datë 15.01.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “German Doors” SH.P.K., me numër unik identifikues 811253799 dhe seli në Fushë Kosovë, ashtu që Urdhri Përbarimor P.nr. 257/23, i lejuar më datë 15.06.2023, nga Përbaruesi Privat Liridon Tërshani, ANULOHET
- II. DETYROHET kreditori “FE Doors” Sh.P.K., që, në emër të shpenzimeve për përpilimin e prapësimit, t’ia paguaj debitorit “German Doors” Sh.P.K., shumën në lartësi prej EUR 104.00 (njëqind e katër Euro), në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, mbi bazën e dokumentit - Faturës nr. FSM-21-000003, e datës 16.01.2023, ka lejuar Urdhrit përbarim P.nr. 257/23, i lejuar më datë 15.06.2023, me të cilin është urdhëruar debitori që, brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhrit, t’ia paguaj kreditorit shumën prej EUR 800.00, me kamatë ligjore

prej ditës së dorëzimit të propozimit e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Debitori, në prapësimin e ushtruar përmes përfaqësuesit të autorizuar, e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor, me arsyetim se fatura mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri nuk i plotëson kushtet për përmbartim ngase të njëjtën kreditori e ka lëshuar në mënyrë të njëanshme dhe nuk është pranuar dhe nënshkruar në mënyrë të rregullt nga ana e debitorit, ndërsa ka shtuar se lejimi i përmbartimit është bërë pa u plotësuar kushtet ligjore në kuptim të nenit 29 par. 1.3 të LPP-së, pasi që ky dokument nuk ka asnjë identifikim të pranueshmërisë së të njëjtës. Tutje, ka theksuar se dëshminë të cilën kreditori e ka bashkangjitur në propozimin për përmbartim duke pretenduar se debitori ka pranuar faturës, është dëshmi e cila nuk përmban asnjë lloj përshkrimi me të cilin do të vërtetohej se kreditori ka dorëzuar faturën mbi bazën e së cilës është iniciuar procedura përmbartimore. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta aprovoj si të bazuar dhe urdhri përmbartimor të anulohet, ndërsa të obligohet kreditori që debitorit t'ia paguaj shumën prej EUR 104.00, në emër të prapësimin të paraqitur.

Kreditori, në përgjigje në prapësim të ushtruar përmes përfaqësuesit të autorizuar, ka theksuar se prapësimi i paraqitur nga debitori është i pabazuar, për shkak se me datë 02.06.2023 kreditori e ka njoftuar debitorin lidhur me mos përmbushjen e obligimit të papaguar ndaj kreditori duke i dhënë mundësinë që obligimi të përmbushet në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të njoftimit për evitimin e inicimit të procedurës përmbartimore. Andaj, qëllimi i debitorit është prolongimi e përmbushjes së obligimeve. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pabazuar, ashtu që urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe përgjigje në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (në tekstin e mëtejshëm: “LPP”) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të anulohet, për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29, paragrafi 1 i LPP-së, “*Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm*”, ndërsa, pika 1.3 e njëjtë nen ka përcaktuar faturën si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, në paragrafin 3 të këtij neni është përcaktuar se: “*Dokumenti i besueshëm është i përshatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe*

debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”. Në anën tjetër, me nenin 37 të LPP-së parashihet se: *“Kur propozimi për përbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*

Gjykata, duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se fatura mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri përbarimor nuk i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm, ngase nuk mund të vërtetohet se e njëjta është dorëzuar në mënyrë të rregullt nga ana e kreditorit dhe se është pranuar nga debitori, për arsye se të njëjtës i mungon nënshkrimi apo vula e pranimin të debitorit. Në anën tjetër, kreditori nuk ka arritur të dëshmojë se në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme ia ka dorëzuar debitorit faturën mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri, ndërsa ky i fundit të njëjtën e ka pranuar dhe është njoftuar me detyrimin që buron nga kjo faturë.

Në anën tjetër, gjykata nuk mund ta konsideroj si të rregullt dorëzimin e faturës dhe njoftimit për përmbushjen e obligimit të dorëzuar përmes postës nga ana e kreditorit, ngase në dëftesën për pranimin e dërgesës me numër 2973702, e datës 02.05.2023, nuk është specifikuar lloji i dërgesës së adresuar tek debitori. Prandaj, në mungesë të përshkrimit të llojit të dërgesës, gjykata nuk mund të dijë përmbajtjen e dërgesës së adresuar tek debitori dhe nëse debitori ka pranuar dërgesë me përmbajtje të faturës mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri. Andaj, nisur nga një gjendje e tillë, gjykata vlerëson se fatura mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri, është lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit, dhe si e tillë, nuk është e përshtatshme për përbarim.

Bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura mbi bazën e së cilës mbështetet propozimi për përbarim, e mbi bazën e të cilit organi përbarues ka lejuar përbarimin, nuk ka tipare të përbarueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përbaruesit duhet të anulohet.

Lidhur me shpenzimet e procedurës përbarimore gjykata vendosi në kuptim të dispozitave të nenit 463 të LPK-së, lidhur me nenin 17 të LPP-së, duke ia njohur shpenzimet debitorit në emër të prapësimin të ushtruar përmes përfaqësuesit të autorizuar, në vlerë prej EUR 104.00, konform rregullores në fuqi për tarifën e avokatëve.

Nga sa më sipër, gjykata në kuptim të nenit 71, paragrafi 1.1 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1035/23, datë 15.01.2024

Gjyqtari
Arbër Rexha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.